



A.2.1. RenovAID Report

Vështrim krahasues i kornizave të
Certifikatës së Performancës së Energjisë
në Kosovë, Shqipëri & rekomandimet
politike të Bashkimit Evropian

*Magdalena Blachowiak
Valbona Mazreku
Arion Sauku
Dardan Abazi
Burim Ejupi*

Dizenjuar nga



Ky projekt është pjesë e Nismës Evropiane për Klimën (EUKI) e Ministrisë Federale Gjermane për Çështjet Ekonomike dhe Veprimin për Klimën (BMWK).

Projekti “RenovAID - Mbështetje Strukturore në Shumë Nivele për Përmirësimin e Efiçencës së Energjisë në Ndërtesa në Kosovë dhe Shqipëri” synon të rrisë efiçencën e energjisë në ndërtesa në këto rajone. Efiçenca e energjisë është thelbësore për uljen e emetimeve të gazeve serrë, uljen e kostove të energjisë dhe sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm. Ky raport përmbledh gjetjet nga studime gjithëpërfshirëse të kryera në Kosovë dhe Shqipëri, duke ofruar njohuri mbi pengesat aktuale dhe duke propozuar rekomandime të zbatueshme për kornizat politike dhe masa praktike për përmirësimin e efiçencës së energjisë në ndërtesa.

Raporti paraqet një përmbledhje të gjendjes aktuale, sfidave dhe rekomandimeve për përmirësimin e efiçencës së energjisë në ndërtesa në Kosovë dhe Shqipëri. Gjetjet kryesore tregojnë për pengesa të dukshme, si kufizime financiare, mungesa e ndërgjegjësimit publik dhe korniza të pamjaftueshme ligjore. Raporti vë theksin te nevoja për mbështetje të mirë financiare, fushata në rritje për ndërgjegjësimin publik dhe zbatim më të rreptë të rregulloreve për të arritur objektivat për efiçencën në energji. Përpjekjet e përbashkëta ndërmjet institucioneve shtetërore, sektorit privat dhe organizmave ndërkombëtare janë thelbësore për të çuar përpara agjendën e efiçencës së energjisë në përputhje me standardet evropiane.

Varshavë, Prishtinë, Tiranë, 2024

Supported by:



on the basis of a decision
by the German Bundestag

RenovAID

Multi-level structural support
for improving energy efficiency
in buildings in Kosovo and Albania



TABELA E PËRMBAJTJES

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	9
1. HYRJJE	11
1.1. Baza logjike	11
1.2. Roli i Certifikatës së Performancës Energjetike në politikat për klimën	12
1.3. Metodologjia	16
2. PAMJE E PËRGJITHSHME E POLITIKËS	
2.1. Bashkimi Evropian	19
2.2 Kosova	20
2.3 Shqipëria	24
3. VLERËSIMI I POLITIKAVE	
3.1.Hendeqet në politika në vendet e synuara lidhur me kornizat e Certifikatës së Performancës Energjetike në BE	29
4. REKOMANDIME	
4.1 Fusha politike kyçe që kanë nevojë për përmirësim	32

SHKURTIME

CPE - *Certifikata e Performancës së Energjisë*

DPEN - *Direktiva për Performancën e Energjisë në Ndërtesa*

NTZE - *Ndërtesa Thuajse me Zero Energji*

PKVEE - *Plani Kombëtar i Veprimit për Efiçencën në Energji*

PKEK - *Plani Kombëtar i Klimës dhe Energjisë*



PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Projekti “RenovAID - Mbështetje Strukturore në Shumë Plane për Përmirësimin e Efiçencës së Energjisë në Ndërtesa në Kosovë dhe Shqipëri” synon të rrisë efiçencën e energjisë në ndërtesa në këto rajone. Efiçenca e energjisë është thelbësore për uljen e emetimeve të gazeve serrë, uljen e kostove të energjisë dhe sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm. Ky raport jep një përmbledhje të kuadrit të Bashkimit Evropian për Certifikatën e Performancës së Energjisë (CPE), si dhe një analizë të qasjeve ekzistuese për CPE në Kosovë dhe Shqipëri. Ai vë në dukje gjendjen aktuale të kuadrit për CPE në të dy vendet, duke përshkruar sfidat që ato hasin për t'u përfruar me standardet e BE-së për efiçencën e energjisë në ndërtesa.

Gjetjet kryesore zbulojnë hendeqe të ndjeshme në politikat përkatëse. Të dyja vendet përballen me mekanizma të dobët zbatimi, mungesë ndërgjegjësimi publik, kapacitete të pamjaftueshme komunale, mungesë stimujsh të fortë financiarë, mungesë të platformave digjitale të centralizuara dhe mundësi të kufizuara për trajnimin e audituesve dhe certifikuesve të energjisë. Këto probleme të përbashkëta theksojnë një mundësi për bashkëpunim rajonal dhe shkëmbim njohurish, veçanërisht në ndërtimin e kapaciteteve, digjitalizim dhe fushata të ndërgjegjësimit publik. Përmes bashkimit të burimeve dhe ekspertizës, të dyja vendet mund t'i trajtojnë këto zbrazëti në mënyrë më të efektshme dhe të përafrohen me standardet e BE-së.

Përveç çështjeve të përbashkëta, secili vend përballlet me sfida unike që kërkojnë zgjidhje të posaçme. Për Kosovën, mungesa e standardeve të detyrueshme për Ndërtesat me Konsum thuajse Zero të Energjisë (NTZE) përbën një hendek vendimtar, pasi këto standarde janë thelbësore për përmbushjen e objektivave të BE-së për performancën energjetike. Kosova gjithashtu vë theksin te promovimi i përfshirjessë sektorit privat, përshtetshmërisë partneriteteve publike-private (PPP), për të financuar projekte të mëdha për rinovimin e ndërtesave – strategji që nuk është aq e theksuar në Shqipëri. Nga ana tjetër, Shqipëria ka një kuadër ligjor



më të fortë për integrimin e energjisë së rinovueshme, por i mungojnë stimujt efektivë për të nxitur zbatimin praktik – një fushë që Kosova po e çmon gjithnjë e më të rëndësishme për përafrimin me kornizën për CPE.

Duke trajtuar si sfidat e përbashkëta, ashtu dhe ato specifike për secilin vend, Kosova dhe Shqipëria mund të krijojnë politika më gjithëpërfshirëse dhe të efektshme për eficientë e energjisë. Përpjekjet e përbashkëta mund të përqendrohen te dobësitë që të dyja i kanë, ndërsa strategjitë e përshtatura mund të sigurojnë që prioritetet specifike të secilit vend – si standardet NTZE për Kosovën dhe stimujt për energjinë e rinovueshme për Shqipërinë – të trajtohen si duhet. Së bashku, këto përpjekje do të forcojnë kuadrin për CPE në secilin vend, do të përshpejtojnë përafrimin me direktivat e BE-së dhe do të kontribuojnë në objektivat rajonale për eficientë energjetike dhe qëndrueshmëri.



1. HYRJJE

1.1. BAZA LOGJIKE

Synimi i raportit Qëllimi i këtij raporti është një analizë krahasuese e hollësishme e kornizave për Certifikatën e Performancës së Energjisë (CPE) në Kosovë, Shqipëri dhe Bashkimin Evropian, që synon të njehsojë hendeqet në politika dhe të japë rekomandime për përmirësimin e efijencës së energjisë në këto rajone. Ky raport shpreson të ndihmojë politikëbërësit, palët e interesuara dhe profesionistët e përfshirë në sektorët e energjisë dhe ndërtimit, duke ofruar njohuri që do të kontribuojnë në zhvillimin e kornizave rregullatore më të forta dhe qasjeve praktike për zbatimin e CPE.

Duke e përafruar sistemin CPE të Kosovës dhe Shqipërisë me standardet e BE-së, raporti synon të lehtësojë ecjen drejt arritjes së objektivave për efijencën e energjisë, trajtimin e varfërisë energjetike, përmirësimin e qëndrueshmërisë në ndërtesa dhe më shumë garanci në furnizimin me energji. Këto përmirësime janë thelbësore për avancimin e strategjive afatgjata të rinovimit që jo vetëm rrisin performancën energjetike, por gjithashtu kontribuojnë në objektiva më të gjera klimatike, në kursimet ekonomike dhe në ndërtimin e një infrastrukture më dinamike në Kosovë dhe Shqipëri.

Me këtë përmbledhje krahasuese, raporti do të luajë një rol kyç në përrudhjen për hartimin e politikave dhe zbatimin e programeve, duke mbështetur si qeveritë kombëtare ashtu dhe sektorin privat në nxitjen e një të ardhmeje më të qëndrueshme dhe me efijencë energjitike. Njohuritë që raporti paraqet do të jenë thelbësore për të nxitur përpjekje të bashkërenduara midis grupeve të interesit rajonale dhe ndërkombëtare, duke siguruar që këto vende të arrijnë objektivat e tyre për efijencën e energjisë dhe klimën në përputhje me standardet e BE-së.

1.2. ROLI I CERTIFIKATËS SË PERFORMANCËS ENERGETIKE NË POLITIKAT E KLIMËS

BASHKIMI EVROPIAN

Certifikata e Performancës së Energjisë (*CPE*) luan një rol kyç në politikat klimatike të Bashkimit Evropian, veçanërisht në trajtimin e konsumit të energjisë në ndërtesa, që janë konsumatorët më të mëdhenj të energjisë në Evropë. Me rreth 85% të ndërtesave të BE-së të ndërtuara para vitit 2000 dhe 75% prej tyre me performancë të dobët energjetike, përmirësimi i efijencës së energjisë në sektorin e ndërtesave është thelbësor për arritjen e objektivave të BE-së për energjinë dhe klimën.

Sipas Eurostat dhe Agjencisë Evropiane për Mjedisin, rreth 40% e konsumit total të energjisë në BE dhe mbi një e treta e emetimeve të gazeve serrë që lidhen me energjinë vijnë nga ndërtesat. Veçanërisht, afërsisht 80% e energjisë së përdorur në shtëpitë e BE-së shkon për ngrohje, ftohje dhe ujë të ngrohtë.

CPE-të u ofrojnë konsumatorëve informacion thelbësor mbi efijencën e energjisë në ndërtesat që ata duan të blejnë apo të marrin me qira. Këto certifikata përfshijnë një vlerësim të performancës energjetike si dhe këshilla për përmirësime me kosto të përballueshme. CPE-të duhet të përfshihen në të gjitha reklammat për pronat në mediat tregtare dhe t'u vihen në dispozicion qiramarrësve ose blerësve potencialë gjatë ndërtimit, shitjes apo dhënies me qira të pronës. Me përfundimin e marrëveshjes, certifikata duhet t'i dorëzohet pronarit ose qiramarrësit të ri.

Për më tepër, *CPE-të* zbulojnë dhe metoda me kosto të përballueshme që përmirësojnë performancën energjetike të një ndërtese dhe, kur mund të bëhet, japin informacion mbi instrumentet financiare që mbështesin përmirësimet për efijencë energjetike. Duke promovuar transparencë dhe vendimmarrje të informuar, *CPE-të* mbështesin objektivat më të gjera të politikave të BE-së, siç përvijohen në Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane (European Green Deal), Strategjinë e Valës së Rinovimit (Renovation Wave) dhe Direktivën për Performancën e Energjisë në Ndërtesa (Energy Performance



of Buildings Directive), të cilat synojnë një fond ndërtimi me zero emetime dhe plotësisht të çkarbonizuar deri në vitin 2050.

SHQIPËRIA

Certifikata e Performancës së Energjisë (*CPE*) luan një rol thelbësor në politikat klimatike të Shqipërisë, duke promovuar efikasitetin energjetik në ndërtesa – një aspekt kyç për uljen e emetimeve të gazeve serrë (GHG). *CPE* përputhet me angazhimet e Shqipërisë në kuadër të Marrëveshjes së Parisit dhe Kontributit Kombëtar të Përcaktuar (NDC), i cili synon pakësimin e emetimeve të GHG me 11.5% deri në vitin 2030 krahasuar me nivelet e vitit 2016. Kjo ndihmon vendin të arrijë objektivat e veta klimatike duke ulur konsumin e energjisë dhe duke përmirësuar performancën e ndërtesave. Një raport i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (2019) e tregon sektorin e ndërtimit si përparësi për uljen e emetimeve në Shqipëri, duke theksuar nevojën për përdorimin e *CPE*-ve për të ulur emetimet dhe varësinë nga lëndët djegëse fosile për ngrohje dhe ftohje.

Ndërsa Shqipëria vijon të harmonizojë politikat e veta me Direktivën e BE-së për Efikasitetin e Energjisë (EED), *CPE*-të shërbejnë si një mjet jetik për gjurmimin dhe përmirësimin e efikasitetit të energjisë si në ndërtesat e reja, ashtu dhe në ato ekzistuese.

Plani Kombëtar i Veprimeve për Efikasitetin e Energjisë (PKVEE) i Shqipërisë vë si objektivi që, deri në vitin 2020, të pakësojë 9% të konsumit final të energjisë krahasuar me një skenar "të zakonshëm". *CPE*-të janë një nga mjetet për arritjen e këtij objektivi, veçanërisht në sektorin e ndërtimit, i cili përbën një pjesë të madhe të konsumit të energjisë. Veçanërisht, sipas masave të emergjencës energjetike të vitit 2022, konsumatorët shqiptarë arritën të kursejnë rreth 4% të energjisë elektrike krahasuar me vitin e mëparshëm.

Sipas Planit Kombëtar për Energjinë dhe Klimën 2030 (PKEK), Shqipëria është zotuar që të përmirësojë më tej



efiçencën e energjisë në përputhje me direktivat klimatike dhe energjetike të BE-së, duke pasur si fokus kryesor sektorin e ndërtesave.

Në përputhje me qëllimin e Shqipërisë për të kaluar drejt një ekonomie me emetime të ulëta karboni, *CPE*-të mbështesin ndërtimin e ndërtesave me konsum thuajse zero energji (NTZE) dhe integrimin e energjive të rinovueshme në sektorin e ndërtimit. Korniza *CPE* nxit pronarët e pasurive që të zbatojnë masa kursimi energjie, duke pakësuar kërkesën për energji dhe emetimet përkatëse. Në Shqipëri, sektori i ndërtesave është përgjegjës për një pjesë të ndjeshme të konsumit të energjisë, veçanërisht për ngrohje, ftohje dhe energji elektrike. Sipas vlerësimeve të ndryshme, ndërtesat përbëjnë rreth 40% të konsumit total të energjisë në vend, në përputhje me prirjet botërore.

CPE-të synojnë të pakësojnë konsumin duke njehsuar masa për kursimin e energjisë dhe duke certifikuar performancën e ndërtesave. Auditimet energjetike dhe *CPE*-të u ofrojnë pronarëve këshilla për të ulur kërkesën për energji, duke ndikuar drejtpërdrejt në uljen e konsumit energjetik.

Ndërtesat publike, në veçanti, po japin shembull duke ndihmuar që efiçenca e energjisë të jetë pjesë e veprimeve më të gjera klimatike. Kjo gjithashtu i mundëson Shqipërisë që të aksesojë financime ndërkombëtare për projekte që lidhen me efiçencën energjetike.

Duke ofruar të dhëna mbi konsumin e energjisë, *CPE*-të ndihmojnë në monitorimin dhe raportimin e ecurisë drejt objektivave kombëtare klimatike. Ato janë të vlefshme në përafrimin e politikave klimatike të Shqipërisë me politikat rajonale, si Marrëveshja e Gjelbër Evropiane, dhe në rritjen e qëndrueshmërisë së vendit përballë ndikimeve nga ndryshimet klimatike. Përmes përmirësimeve që sjell *CPE*, Shqipëria jo vetëm që po ul gjurmën e saj të karbonit, por dhe po trajton sigurinë energjetike dhe varfërinë energjetike, duke kontribuar në një të ardhme të qëndrueshme dhe dinamike ndaj ndryshimeve klimatike.



KOSOVA

Politikat klimatike të Kosovës në lidhje me Certifikatën e Performancës së Energjisë (*CPE*) e quajnë atë si një mjet thelbësor që kontribuon drejtpërdrejt në përmirësimin e efijencës së energjisë dhe në uljen e emetimeve të gazeve serrë. Si pjesë e kornizës ligjore të vendit, ligji “Për Efiçencën e Energjisë” (ligji nr. 06/L-079) përcakton udhëzime të qarta për përmirësimin e standardeve energjetike në nivel kombëtar. *CPE*-të janë thelbi i këtyre përpjekjeve, duke ofruar një sistem vlerësimi për matjen e konsumit të energjisë në ndërtesa dhe duke promovuar transparencën për banorët dhe transaksionet e pronës.

Strategjia për efiçencën e energjisë në Kosovë synon certifikimin e të gjitha ndërtesave publike, private dhe tregtare deri në vitin 2031. Gjithashtu, strategjia thekson rëndësinë e certifikimit të 150 Ndërtesave me konsum thuajse Zero të Energjisë (NTZE), duke nënvizuar rolin që luajnë *CPE*-të në arritjen e këtyre objektivave.

CPE-të ndërthuren dhe me ligjin “Për burimet e ripërtëritshme të energjisë” (ligji nr. 08/L-258), i cili përkrah adoptimin e teknologjive të energjisë së ripërtëritshme. Kjo sinergji ndihmon në kursimin e energjisë dhe në integrimin e burimeve të qëndrueshme në ndërtesa, duke ndihmuar tranzicionin e Kosovës drejt sistemeve më të pastra të energjisë. Programe si “USAID Energy Sustainability Activity” u japin mbështetje këtyre përpjekjeve duke përmirësuar sigurinë energjetike, duke nxitur investimet në infrastrukturë me efiçencë energjetike dhe duke forcuar kapacitetet institucionale për të mbështetur rritjen e tregut.

Megjithatë, disa sfida ende pengojnë përhapjen e gjerë të *CPE*-ve. Ndërgjegjësimi i ulët publik dhe mungesa e ekspertizës në proceset e auditimit energjetik ulin efektshmërinë e tyre. Për më tepër, Kosova përballet me mungesë infrastrukturë dhe fondesh, çka vështirëson zbatimin dhe monitorimin e masave për efiçencë energjetike. Trajtimi i këtyre pengesave është kyç për arritjen e potencialit të plotë të *CPE*-ve në zbatimin e politikave klimatike.



Roli i *CPE*-ve në Kosovë shkon përtej rregullimit ligjor – ato mbështesin zhvillimin e tregut dhe ndërgjegjësimin publik për konsumin e energjisë. Duke ofruar metrika të standardizuara për performancën energjetike, *CPE*-të kontribuojnë në transparencën e nevojshme për marrje vendimesh të informuara në tregun e pasurive të paluajtshme. Këto certifikata jo vetëm që përputhen me detyrimet ndërkombëtare për klimën, por gjithashtu mbështesin përpjekjet vendore për të ulur konsumin e energjisë dhe lëshimin e gazeve serrë.

Kosova përfiton nga bashkëpunimi ndërkombëtar në nismat për efikasitet energjetike. Organizma si Bashkimi Evropian dhe USAID ofrojnë mbështetje teknike dhe financiare kritike, duke siguruar që kornizat ligjore dhe institucionale të vendit të jenë të përgatitura për zbatimin dhe monitorimin e programeve të efikasitetit, duke përfshirë *CPE*-të. Këto partneritete e ndihmojnë Kosovën që të përmirësojë standardet e veta energjetike, ndërsa trajton sfidat që lidhen me zhvillimin dhe pajtueshmërinë.

CPE-të përfaqësojnë një gur themeli në strategjinë klimatike të Kosovës, duke mbështetur objektivat për efikasitet energjetike, transparencë në treg dhe angazhime ndërkombëtare. Zbatimi efektiv i tyre do të jetë vendimtar për arritjen e synimeve afatgjata për qëndrueshmëri të vendit.

1.3. METODOLOGJIA

ARSYETIMI I METODOLOGJISË

Për këtë raport, metodologjia e përdorur përfshin një analizë të thelluar të dokumenteve strategjike, programore dhe legjislative të autoriteteve publike, duke përfshirë Komisionin Evropian. Kjo qasje siguron një të kuptuar të plotë të kornizave politike dhe kontekstit ligjor që ndikon në kornizat e Certifikatës së Performancës së Energjisë në Kosovë, Shqipëri dhe Bashkimin Evropian.

Analiza e dokumenteve strategjike dhe teksteve legjislative është thelbësore për të njehsuar parimet udhëzuese, objektivat dhe kërkesat që drejtojnë kornizën e



CPE-ve. Kjo metodë mundëson një shqyrtim të imtësishëm të politikave dhe rregulloreve që modelojnë standardet dhe praktikat e performancës energjetike. Duke u përqendruar te dokumentet e autoriteteve publike dhe Komisionit Evropian, raporti përputhet me normat dhe direktivat e përcaktuara, duke siguruar që gjetjet të jenë me vlerë dhe në përputhje me objektivat dhe standardet më të gjera të BE-së.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË

Analiza përfshiu një shqyrtim sistematik të dokumenteve kryesore strategjike, duke përfshirë Strategjinë e Valës së Rinovimit dhe Direktivën për Performancën e Energjisë në Ndërtesa. Gjithashtu, u ekzaminuan politikat dhe legjislacioni kombëtar i Kosovës dhe i Shqipërisë për të kuptuar përputhshmërinë e tyre me standardet e Bashkimit Evropian.

Kjo përfshinte vlerësimin e përmbajtjes, objektivave dhe mekanizmave të zbatimit të këtyre dokumenteve për të analizuar se si e trajtojnë performancën energjetike dhe për të identifikuar zbrazëtite e mundshme në politika.

Metodologjia përfshinte dhe një analizë krahasuese për të nxjerrë në pah dallimet dhe ngjashmëritë midis kornizave të vendeve të synuara dhe të BE-së, duke ofruar kështu një bazë për rekomandime të zbatueshme.



2. PAMJE E PËRGJITHSHME E POLITIKËS

2.1. BASHKIMI EVROPIAN

Pamje e përgjithshme e kornizës së Bashkimit Evropian për Certifikatën e Performancës së Energjisë

Certifikata e Performancës së Energjisë u paraqit për herë të parë në kuadër të Direktivës për Performancën e Energjisë në Ndërtesa (Direktiva 2002/91/EC) dhe u rishikua në vitin 2024 (EU/2024/1275) si pjesë e objektivave më të gjera klimatike të Bashkimit Evropian, duke përfshirë Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane. CPE-të garantojnë që ndërtesat i përmbushin standardet minimale të performancës energjetike dhe përditësohen rregullisht si pjesë e rregulloreve kombëtare. Ato gjithashtu japin të dhëna me vlerë për gjurmimin e konsumit të energjisë dhe emetimeve, duke mbështetur përparimin drejt objektivave të BE-së për klimën për vitet 2030 dhe 2050.

Në tetor 2020, Komisioni Evropian paraqiti strategjinë Renovation Wave si pjesë e Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane. Kjo nismë synon që, deri në vitin 2030, të dyfishojë shkallën vjetore të rinovimit energjetik në ndërtesa, të ulë emetimet dhe të krijojë vende pune të gjelbra, ndërkohë që përmirëson standardet e jetesës. Strategjia vë në dukje rolin e CPE-ve në ofrimin e transparencës për efikasitetin e energjisë në ndërtesa dhe propozon përditësime të kornizës CPE, duke përfshirë teknologji të reja matjeje dhe një format të dhënash të njësuar, të lexueshëm në mënyrë digjitale në të gjithë BE-në.

Veç kësaj, Direktiva për Efikasitetin Energjetik (EU/2023/1791), e rishikuar më shtator 2023, plotëson kornizën e CPE-ve duke zgjeruar kërkesat për rinovimin e ndërtesave publike dhe duke vënë objektiva për uljen e konsumit të energjisë në sektorin publik. Së bashku, këto rregullore nxisin kursim energjie, pakësim të CO₂ dhe përkrahin praktika të qëndrueshme ndërtimi në të gjithë Bashkimin Evropian.

Direktiva e Performancës së Energjisë në Ndërtesa (EU/2024/1275)

Akti më i rëndësishëm ligjor është Direktiva për Performancën e Energjisë në Ndërtesa (EU/2024/1275), e rishikuar së fundmi, që përfshin një kornizë të përditësuar për Certifikatat e Performancës së Energjisë në të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Kjo direktivë detyron shtetet anëtare që të zbatojnë një sistem të standardizuar për CPE-të, i cili i vlerëson dhe i kategorizon ndërtesat sipas efijencës energjetike, duke përdorur një shkallë nga A (zero-lëshim) deri në G (më pak efijentja). CPE-të duhet të shfaqin tregues kyç si konsumi i energjisë primare, emetimet e gazeve serrë, rekomandime për rinovime, duke garantuar

Ato duhen lëshuar nga ekspertë të kualifikuar, të ruhen në bazat e të dhënave kombëtare dhe të përditësohen rregullisht për të ruajtur saktësinë dhe besueshmërinë e tyre. (L_202401275EN.000101.fmx.xml (europa.eu)).

2.2. KOSOVA

Korniza e Certifikatës së Performancës së Energjisë (CPE) në Kosovë është pjesë e përpjekjeve më të gjera për përmirësimin e efijencës së energjisë dhe arritjen e objektivave të politikave klimatike. Këto korniza janë skicuar për t'u përshtatur me standardet ndërkombëtare, si Direktiva për Performancën e Energjisë në Ndërtesa (DPEN), duke pasqyruar politikat dhe prioritetet kombëtare. Sistemi CPE mbështet zhvillimin e qëndrueshëm duke integruar kërkesat ligjore, mekanizmat e përmbushjes dhe programet e efijencës së energjisë. Kjo përmbledhje shqyrton pesë pika kyçe të kornizës CPE në Kosovë: ligjin për CPE-në, përputhshmërinë me DPEN-në, Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (PKEK), ligjin për Energji të Rinovueshme, dhe Programet Qeveritare e Komunale.

1. LIGJI “PËR EFIÇENCËN E ENERGIJË” (LAW NO. 06/L-079)

Ligji “Për efijencën e energjisë” në Kosovë (nr. 06/L-079) shërben si shtylla ligjore për zbatimin e CPE-ve.



Ai kërkon certifikimin e performancës energjetike për ndërtesat, duke përcaktuar kërkesa të detajuara për auditime, proceset e certifikimit dhe monitorimin e përputhshmërisë. Ky ligj detyron lëshimin e CPE-ve për ndërtesat publike dhe private, sidomos gjatë ndërtimit, shitjes a qiradhënies. Për më tepër, ai parashikon masa ndëshkuese në rast mosrespektimi për të siguruar zbatimin. Duke u përshtatur me standardet evropiane, ligji rreket të përmirësojë efikasitetin energjetik në fondin e ndërtesave në Kosovë, duke kontribuar në uljen e përgjithshme të emetimeve. Proceset e certifikimit që përvijohen në ligj synojnë vlerësimin dhe përmirësimin e përdorimit të energjisë, duke rritur ndërgjegjësimin të pronarët dhe blerësit e pronave ndërsa mbështesin qëllimet klimatike. Gjithashtu, ligji stimulon rinovimet me efikasitet energjetik përmes mekanizmave financiare, duke krijuar një rrugë praktike drejt kursimeve të energjisë.

2. PËRPUTHSHMËRIA ME DIREKTIVËN PËR PERFORMANCËN E NDËRTESAVE

Përpjekjet e Kosovës për tu përshtatur me DPEN-në pasqyrojnë ambicien për integrim me standardet e BE-së. Edhe pse nuk është anëtare e BE-së, Kosova ka miratuar masa që përputhen ngushtë me DPEN-në, me qëllim përmirësimin e efikasitetit energjetik në ndërtesa dhe uljen e kërkesës për energji. Përputhshmëria me DPEN-në përfshin vënien e standardeve minimale për performancën energjetike në ndërtesat e reja dhe ato ekzistuese, përmirësimin e skemave të certifikimit dhe promovimin e ndërtesave me konsum thuajse zero energjie (NTZE). Korniza e certifikimit kërkon inspektime periodike të sistemeve të ngrohjes dhe ftohjes dhe përfshirjen e DPEN-ve në transaksionet e pronësisë. Kosova gjithashtu ndjek fokusin e DPEN-së për rritjen e ndërgjegjësimit publik për efikasitetin e energjisë përmes etiketimit transparent dhe stimuljeve të bazuar në treg. Këto përpjekje e pozicionojnë Kosovën si partner të angazhuar në bashkëpunimin rajonal për energjinë dhe klimën, pavarësisht statusit joanëtar të BE-së.

3. PLANI KOMBËTAR I ENERGJISË DHE KLIMËS

Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës i Kosovës (PKEK) nënvizon rëndësinë që CPE-të kanë në arritjen e objektivave kombëtare për efikasitetin e energjisë dhe klimës. PKEK vendos qëllime ambicioze, si ulja e konsumit të përgjithshëm të energjisë dhe rritja e pjesës së energjisë së rinovueshme në strukturën kombëtare. CPE-të janë mjete jetike për matjen, monitorimin dhe raportimin e performancës energjetike, veçanërisht në sektorët e banimit dhe publik. Deri në vitin 2031, PKKE synon të arrijë kursime energjie kumulative prej 266.4 ktoe në ndërtesa dhe të certifikojë të paktën 150 ndërtesa me konsum thuajse zero energjie (NTZE). Këto qëllime lidhen direkt me kornizën CPE duke vendosur pika referimi të qarta për standardet e energjisë në ndërtesa. PKKE gjithashtu thekson rolin e CPE-ve në mbledhjen dhe analizën e të dhënave, të cilat informojnë në vendimmarrje dhe rrisin llogaridhënien.

4. LIGJI “PËR ENERGJINË E RINOVUESHME” (LIGJI NR. 08/L258)

Ligji “Për energjinë e rinovueshme” i Kosovës plotëson kornizën CPE duke përkrahur integrimin e burimeve të energjisë së rinovueshme në ndërtesa. Ky ligj nxit përdorimin e paneleve diellore, biomasës dhe burimeve të tjera të energjisë së rinovueshme për të përmirësuar efikasitetin e ndërtesave. CPE-të luajnë rol kritik në vlerësimin e përshtatshmërisë së ndërtesave me instalimet e energjisë së rinovueshme dhe në sigurimin e përputhshmërisë me objektivat për energji të rinovueshme. Ligji kërkon auditime energjetike për ndërtesat për të vlerësuar potencialin e tyre në përdorimin e energjisë së rinovueshme, duke forcuar lidhjen midis CPE-ve dhe qëllimeve të qëndrueshmërisë. Për më tepër, ligji nxit pronarët e pasurive që të investojnë në sisteme energjie të rinovueshme përmes subvencioneve, granteve dhe uljeve tatimore. Duke lidhur adoptimin e energjisë së rinovueshme me certifikatat e performancës së energjisë, Kosova krijon një kornizë organike që merret si me efikasitetin e energjisë, ashtu dhe me qëndrueshmërinë.



5. PROGRAMET QEVERTARE DHE KOMUNALE

Programet qeveritare dhe komunale janë thelbësore për vënien në jetë të CPE-ve në Kosovë. Këto programe ofrojnë mbështetje teknike dhe financiare për nismat e efijencës së energjisë, duke siguruar që CPE-të të jenë të aksesueshme për një gamë të gjerë palësh të interesuara. Në nivel kombëtar, programe si USAID Energy Sustainability Activity përqendrohen në ngritjen e kapaciteteve, zhvillimin e tregut dhe integrimin rajonal energjetik. Në nivel vendor, zyrtat komunale të energjisë shpesh udhëheqin fushata ndërgjegjësimi publik për të edukuar pronarët e pasurive mbi përfitimet nga CPE-të dhe përmirësimet me efijencë energjie. Këto programe ndihmojnë gjithashtu në trajnimet e audituesve dhe certifikuesve të energjisë, duke përmirësuar cilësinë dhe disponueshmërinë e shërbimeve CPE. Për më tepër, komunat luajnë një rol të drejtpërdrejtë në zbatimin e rregulloreve të ndërtimit, kryerjen e inspektimeve dhe lëshimin e certifikatave. Përpjekjet e tyre përputhen me strategjitë kombëtare më të gjera, duke siguruar që masat e efijencës së energjisë të zbatohen në mënyrë të njëtrajtshme në të gjitha rajonet.

Korniza e CPE-ve në Kosovë është shumëfaqëshe, gërsheton masa ligjore, standarde ndërkombëtare dhe nisma vendore për të çuar para efijencën e energjisë dhe veprimin klimatik. Ligji për CPE vendos bazën ligjore për certifikimin, ndërsa përputhshmëria me DPEN siguron harmonizim me praktikatat evropiane. PKEK integron CPE-të në planifikimin kombëtar energjetik, duke i lidhur ato me qëllime ambicioze klimatike. Ligji “Për energjitë e rinovueshme” i vë theksin sinergjisë midis performancës energjetike dhe adoptimit të energjisë së rinovueshme, ndërsa programet qeveritare dhe komunale sigurojnë zbatimin praktik përmes mbështetjes, trajnimeve dhe zbatimit të ligjit. Së bashku, këta përbërës krijojnë një sistem gjithëpërfshirës që mbështet tranzicionin e Kosovës drejt një të ardhmeje energjetike të qëndrueshme. Duke u marrë me hendeqet në ndërgjegjësim, infrastrukturë dhe financim, Kosova mund të rrisë më tej efektshmërinë e kuadrit të saj CPE dhe të kontribuojë në mënyrë domethënëse në përpjekjet globale për klimën.



2.3. SHQIPËRIA

Shqipëria ka përafruar kornizën e vet CPE me standardet e BE-së për efikasitetin energjetik dhe politikën klimatike, si pjesë e strategjisë më të gjerë për të rritur efikasitetin energjetik, ulur lëshimin e gazeve serrë dhe përmbushjen e objektivave për hyrjen në BE. Disa ligje, strategji dhe plane veprimi janë shtylla kurroze të sistemit CPE në Shqipëri. Në vijim jepet një pamje e përgjithshme e politikave kyçe që lidhen me CPE-të:

1. LIGJI “PËR EFIÇENCËN E ENERGJISË” (NR. 124/2015, AMENDUAR NË 2020)

Ky është instrumenti kryesor ligjor për efikasitetin e energjisë në Shqipëri, që gjen përputhje me Direktivën për Efikasitetin e Energjisë në BE (2012/27/EU) dhe që ofron bazën ligjore për vënien në jetë të masave të efikasitetit energjetik në sektorë të ndryshëm, duke përfshirë ndërtesat.

Ligji sanksionon lëshimin e Certifikatave të Performancës së Energjisë për ndërtesat e reja, rinovimet madhore dhe për ndërtesat që shiten ose jepen me qira.

Ai krijon kornizën për auditet e energjisë dhe certifikimin e audituesve të energjisë që janë përgjegjës për vlerësimin dhe lëshimin e CPE-ve.

2. PLANI KOMBËTAR PËR EFIÇENCËN E ENERGJISË (PKVEE)

PKVEE tregon objektivat dhe synimet e Shqipërisë për efikasitetin energjetik, duke synuar që, në vitin 2020, të ulë me 9% konsumin e energjisë krahasuar me vijimin normal të punës.

CPE-të janë mjet kyç i PKVEE në arritjen e kursimit të energjisë në sektorin e ndërtimit. Plani përkrah certifikimin energjetik të ndërtesave dhe vë standarde performace energjie për ndërtesat e reja dhe për ato aktuale që u nënshtrohen rinovimeve.

PKVEE plotëson detyrimet e Shqipërisë sipas Traktatit të Komunitetit të Energjisë, në të cilin Shqipëria është anëtare.



3. PËRPUTHJA ME DIREKTIVËN PËR PERFORMANCËN E ENERGJISË NË NDËRTESA (DPEN)

Shqipëria po përafrohet dita-ditës me Direktivën për Performancën e Energjisë në Ndërtesa (2010/31/EU) që u kërkon shteteve anëtare (dhe atyre candidate si Shqipëria) që të adoptojnë masa për përmirësimin e efijencës së energjisë në ndërtesa.

Direktiva sanksionon futjen e CPE-ve për ndërtesat, cakton standarde minimale për performancën energjetike dhe nxit kalimin drejt ndërtesave me thuajse zero energji (NTZE). Kërkon që në ndërtesat publike, veçanërisht ato që vizitohen shpesh nga publiku, të shpallet dukshëm CPE për të nxitur ndërgjegjësimin për efijencën në energji.

Ligji “Për performancën energjitike në Ndërtesa” nr. 116/2016 u përgatit si një ligj i përveçëm që transpozonte Direktivën e BE-së “Për performancën energjitike në ndërtesa” (DPEN). Ligji është në fuqi që nga janari 2021 dhe përfshin këto kërkesa sipas direktivës së ripunuar:

- Ndërtesat e reja që përdoren ose janë pronë e autoriteteve publike duhet të përputhen me përkufizimin për Ndërtesat me thuajse Zero Energji (NTZE) pas datës 31 dhjetor 2018. United States.

- Për ndërtesat me sipërfaqe të përdorshme mbi 250m², që janë në përdorim ose në pronësi të një autoriteti publik dhe që vizitohen shpesh nga publiku, duhet të afishohet një certifikatë performance energjitike në një vend të dukshëm për publikun.

Ligji paraqet bazën për hartimin e Kërkesave Minimale për Performancën në Ndërtesa (miratuar me VKM nr. 537, datë 08.07.2020) që lidhen me kategori të ndryshme ndërtesash si, renovim, ndërtesë e re, sisteme teknike për ngrohje dhe ftohje etj. Aplikimet kryesore janë si vijon:

- Tërë ndërtesat e reja, njësitë e reja në to, gjatë çdo etape të ndërtimit, duke përfshirë skicimin;

- Ndërtesat aktuale dhe njësi të tyre kur u nënshtrohen rinovimeve domethënëse ose kur janë duke u shtuar/zgjeruar, duke përfshirë skicimin;



- *Elemente individuale në ndërtesa, që janë pjesë e veshjes së ndërtesës, që kanë ndikim të dukshëm në performancën energjetike të ndërtesës, kur zëvendësohen ose kur i shtohen ndërtesës;*

- *Depërtime ajri në ndërtesë;*

- *Sisteme teknike të ndërtesave të reja ose ekzistuese (nëse instalohet ose zëvendësohet një sistem i ri) sa i përket performancës së tyre energjetike, instalimit të duhur, instalimit të sistemeve të kontrollit dhe automatizimit për të rritur efikasitetin.*

Kuadri ligjor përcakton kërkesa të ndryshme për mënyra të ndryshme që ndërtesat kanë për përmbushjen e kërkesave minimale për performancë energjetike. Kushtet mbikëqyren, maten dhe lypset që të tregojnë vlera të posaçme.

Kuadri ligjor përcakton dhe kërkesat minimale për performancë energjike të pajisjeve dhe sistemeve teknike të ndërtesës. Të gjitha sistemet teknike për ndërtesat e reja të banimit dhe jo për banim, sikurse dhe për njësitë e tyre të banimit dhe tregtare ("njësitë"), duhen audituar dhe miratuar sipas skicave inxhinierike për të lëshuar Certifikatën e Përkohshme të Performancës Energjetike në Ndërtesë, sipas standardeve minimale të efikasitetit energjetike.

4. PLANI KOMBËTAR I VEPRIMIT PËR ENERGJINË E RINOVUESHME (PKVER)

PKVER, i hartuar në përputhje me detyrimet që Shqipëria ka sipas Direktivës për Energjinë e Rinovueshme të BE-së (2009/28/EC), fokusohet te rritja e pjesës së burimeve të energjive të përtëritshme në strukturën energjetike në Shqipëri.

CPE-të lidhen me këtë politikë duke zbuluar mundësitë për integrimin në ndërtesa të sistemeve të energjisë së përtëritshme, si panele diellore, për të përmirësuar performancën energjetike dhe pakësuar varësinë nga burimet konvencionale të energjisë.

5. PLANI KOMBËTAR PËR ENERGJINË DHE KLIMËN

PKEK është dokumenti afatgjatë strategjik i Shqipërisë për përafrimin me kornizën për klimën dhe energjinë për BE 2030. Ai tregon se si Shqipëria planifikon të përmbushë objektivat për efikasitetin energjetik, energjinë e përtëritshme dhe uljen e emisioneve.

Struktura e CPE-së mbështet zbatimin e PKEK duke garantuar që përsosjet në performancën energjetike në sektorin e ndërtimit do të kontribuojnë në objektivat e përgjithshme të vendit për energjinë dhe klimën.

Ai fokusohet në uljen e kërkesës për energji në sektorin e ndërtimit që përbën një pjesë të ndjeshme të përdorimit të energjisë dhe të lëshimit të karbonit në Shqipëri.

6. LIGJI “PËR PROMOVIMIN E BURIMEVE TË ENERGJISË SË RINOVUESHME” (2017), I NDRYSHUAR MË 2023, MBËSHTET TRANZICIONIN E SHQIPËRSË NË NJË SISTEM ENERGJIE MË TË GJELBËR.

Ky ligj nxit integrimin e energjisë së përtëritshme në ndërtesa, gjë që rekomandohet shpesh në CPE për të mirësuar performancën energjetike të ndërtesës. Ligji lidhet ngushtë me suazën CPE ngaqë, sisteme me energji të përtëritshme si ngrohja e ujit nga energjia diellore ose panelet fotovoltaike janë përbërës kyç për përsosjen e efikasitetit energjetik që promovohet nga CPE-të.

Amendimet forcojnë mekanizmat e mbështetjes financiare për projekte me energji të përtëritshme, veçanërisht për nisma të vogla dhe që mbështeten në komunitet. Këtu përfshihen stimuj për projekte diellore, eolike, ujore dhe biomase, që lehtësojnë punën për aksesimin në financim dhe mbështetje.

Futja e modelit “prodhues-përdorues” u lejon individëve, sipërmarrjeve dhe bashkësive që të gjenerojnë energji të përtëritshme për përdorimin e tyre dhe që të shesin energjinë e tepërt në rrjetin energjetik. Ky model nxit familjet dhe sipërmarrjet e vogla që të instalojnë panele diellore dhe sisteme të tjera të rinovueshme.



7. PROGRAME QEVERITARE DHE BASHKIAKE

Disa programe kombëtare dhe vendore ofrojnë stimuj financiarë për përsosjen e efikasitetit energjetik në ndërtesa, ku shpesh përfshihen mbështetje për auditime energjie dhe rinovime që shpesh në tërësi të CPE-ve.

Bashkitë po i përfshijnë gjithnjë e më shumë CPE-të në direktivat për planifikimin dhe zhvillimin qytetës, për të promovuar efikasitetin energjetik, veçanërisht në ndërtime të reja dhe ndërtesa publike.

Shqipëria po punon për të vendosur mekanizma si Fondi për Efikasitet Energjetik, që do të financojë masa efikasiteti energjetik në ndërtesa. CPE-të ndihmojnë në njehsimin e projekteve të duhura duke certifikuar kursimet e mundshme të energjisë në ndërtesa, duke i shndërruar ato në të përshtatshme për të përfituar mbështetje financiare.



3. VLERËSIMI I POLITIKAVE

3.1. HENDEQET POLITIKE NË VENDET E SYNUARA NË RAPORT ME KUADRIN E CPE-VE NË BE

KOSOVA

Pavarësisht përparimit, Kosova ka hendeqe politike në kornizën e vet CPE në krahasim me Direktivën e BE-së “Për performancën energjetike në ndërtesa” (DPEN). Mekanizmat e zbatimit për përafrimin me CPE mbeten dobësi vendimtare. Ndonëse ligji parashikon sanksione, Kosova nuk ka sisteme të forta inspektimi dhe monitorimi të performancës së energjisë në ndërtesa. Në dallim, vendet e BE-së përdorin mjete zbatimi më të rrepta, të mbështetura nga sisteme të digjitalizuara që bashkojnë CPE me tregun e pasurive të patundshme.

Ndërgjegjësimi publik për përfitimet nga CPE është tjetër sfidë. Përpjekjet për të edukuar pronarët e pasurive dhe për të promovuar përmirësime në efikasitetin energjetik në Kosovë kanë kufizime në shtrirje dhe në arritje. Kornizat e BE-së e vënë theksin në edukimin e gjerë të konsumatorëve dhe stimujt në tregje që, në Kosovë, janë jo të zhvilluara. Ngjashëm, zyrat e energjisë në komuna në Kosovë nuk kanë burime, personel dhe trajnim për të zbatuar efektshëm dhe për të promovuar standardet e CPE.

Kosova ka mungesë dhe në platforma të përqendruara digjitale për gjurmimin e performancës energjetike në ndërtesa, dhënien e CPE dhe përputhjen me to. Të tilla mjete që përdoren gjerësisht në BE nxisin transparencën, mbledhjen e të dhënave dhe monitorimin. Tjetër hendek shfaqet në integrimin e energjisë së përtëritshme në përmirësimet cilësore të ndërtesave përmes CPE-ve. Ndonëse ligji “Për energjitë e rinovueshme” përputhet me objektivat e BE-së, zbatimi praktik çalon dhe stimujt financiarë për adoptimin e energjisë së rinovueshme mbeten të kufizuara.

Mekanizmat financiare që mbështesin rinovimet me efikasitet energjetik në Kosovë janë të pazhvilluara. Ndryshe nga vendet e BE-së që ofrojnë subvencione të gjera, kredite taksimi dhe hua me interes të ulët, Kosova u ofron pronarëve



më pak opsione kompensimi për kostot e ngritjes cilësore. Veç kësaj, ndërsa PKKE përfshin objektivat për certifikimin e NTZE-ve, Kosova ende nuk ka vënë standarde ose kërkesa të detyrueshme për përputhjen me PKEK, që është gur themeli i DPEN-së.

Së fundi, Kosova përballet me mungesa në profesionistë të trajnuar për të kryer audite dhe certifikime energjie. Vendet e BE-së investojnë rëndshëm në programe forcimi kapacitetesh për të garantuar pasjen e një force punëtore cilësore dhe zbatimin e standardeve të CPE. Në Kosovë, mungesa e mundësive për trajnime pengon vijueshmërinë dhe cilësinë e lëshimit dhe të monitorimit të CPE-ve.

SHQIPËRIA

Shqipëria ka ecur para në kuadrin ligjor për Certifikatën e Performancës së Energjisë duke miratuar ligjet “Për efikasitetin e energjisë” dhe “Për performancën e energjisë në ndërtesa”. Gjithsesi, disa hendeqe në politika pengojnë përputhjen me Direktivën për Performancën e Energjisë në Ndërtesa të BE-së. Sfida të ndjeshme mbeten zbatimi dhe monitorimi i pajtueshmërisë. Ndonëse Shqipëria ka parashikuar sanksione për mospërputhje, mekanizmat e zbatimit nuk aplikohen vijimisht. Sistemet e inspektimit për mbikëqyrjen e performancës energjetike në ndërtesa dhe për zbatimin e kërkesave të CPE nuk janë të zhvilluara, veçanërisht nëse përqasen me mjete rigoroze në vendet e BE-së.

Ndërgjegjësimi publik dhe edukimi për CPE-të dhe përfitimet nga to janë të kufizuara. Përpjekjet për të informuar pronarët e pasurive dhe për të nxitur rinovimet me efikasitet energjetike nuk kanë arritur në shumicën e popullsisë. Kjo mungesë zotimi nga konsumatorët pengon adoptimin e gjerë të CPE-ve dhe integrimin e efikasitetit të energjisë në tregun e patundshmërisë. Tjetër hendek është mungesa e infrastrukturës digjitale për të administruar të dhënat e CPE-ve. Në Shqipëri ende nuk ka një platformë të centralizuar për gjurmimin e lëshimit të CPE-ve, monitorimin e pajtueshmërisë dhe integrimin e të dhënave nga performanca e energjisë në tregun e pasurive të paluajtshme, kjo e fundit diçka standarde për shumicën e vendeve në BE.



Integrimi i teknologjive me energji të rinovueshme në kornizën e CPE-ve mbetet i paplotë. Edhe pse Shqipëria ka politika që nxisin energjinë e përtëritshme, stimujt praktikë për trupëzimin e këtyre sistemeve në ndërtesa mungojnë. Instrumentet financiare që mbështesin rinovimet me efikasitet në energji janë po aq të pazhvilluar. Ndryshe nga vendet e BE-së që ofrojnë subvencione të ndjeshme, stimuj taksimi dhe hua me interes të ulët, mbështetja financiare që Shqipëria u ofron pronarëve të pasurive për përmirësime në energji mbetet e kufizuar.

Veç kësaj, Shqipëria përballlet me mungesë profesionistësh të trajnuar që të vërë në jetë standardet e CPE-së. Mungojnë programe për ngritje kapacitetesh, të nevojshme për të krijuar një grup cilësor audituesish dhe certifikuesish energjie, që shpie në mosvijueshmëri në lëshimin e CPE-ve cilësore dhe monitorimin e pajtueshmërisë. Të tilla hendeqe së bashku pengojnë aftësinë e Shqipërisë për të përmbushur standardet e BE-së për efikasitetin në energji dhe për të çuar përpara efektshëm ndërtimin e qëndrueshëm.



4. REKOMANDIME

4.1. FUSHAT KYÇE POLITIKE QË DUAN PËRMIRËSIM

KOSOVA

Për të fuqizuar kornizën e Certifikatës së Performancës Energjitike të Kosovës dhe për ta përafuar atë me standardet e BE-së, nevojitet vëmendje e menjëhershme në fushat vijuese të politikës:

1. *POLITIKA #1 NGRITJA E NJË NJËSIE TË POSAÇME TË DECENTRALIZUAR PËR EFIÇENCËN NË ENERGJI*

Kosova lypset të krijojë një njësi të posaçme të decentralizuar në nivel komunal për të mbushur hendeqet mes politikave kombëtare dhe zbatimit në vend. Kjo nismë do të përfshinte:

ZYRA ENERGJIE KOMUNALE: *Fuqizimi i zyrave aktuale vendore të energjisë që të veprojnë si bosht për veprimtari që lidhen me CPE-të, duke përfshirë certifikimin, auditet dhe fushata ndërgjegjësimi publik.*

NGRITJA E AFTËSIVE: *Ofroni trajnim të posaçëm për zyrtarët vendorë, audituesit dhe certifikuesit e energjisë, për të garantuar zbatim të njësuar të CPE-ve nëpër rajone.*

ANGAZHIMI I BASHKËSIVE: *Metoda me pjesëmarrje sipas të cilave, në planifikimin për efiçencë energjie të përfshihen bashkësitë vendore dhe pronarët e pasurive. Të tilla metoda mund të jenë punëtoritë, udhëzime financiare dhe aksesimi në burime për përmirësimin e efiçencës energjetike.*

NDARJE DHE MONITORIM TË DHËNASH: *Ngrini një platformë digjitale të përqendruar për të gjurmuar ecurinë e bashkisë në adoptimin e CPE, kursimet në energji dhe përputhjen me objektivat kombëtare që tregohen në PKEK dhe në ligjin “Për efiçencën e energjisë”.*

Duke decentralizuar përgjegjësitë për efiçencën e energjisë, bashkitë mund të gjejnë zgjidhje për secilën sfidë, duke garantuar përputhje më të mirë, monitorim dhe angazhim publik në nivel vendor.



2. POLITIKA #2 PREZANTIMI I MEKANIZMAVE TË POSAÇME FINANCIARE PËR PËRMIRËSIME NË NDËRTESA

Për të përshpejtuar përsosjen e efikasitetit të energjisë, Kosova duhet të vërë në veprim instrumente të posaçme financiare për të nxitur përmirësime në ndërtesa, duke u fokusuar në integrimin e CPE-ve me mbështetjen financiare. Elementet kyçe përmbledhin:

SUBVENCIONE DHE STIMUJ FINANCIARË: *Ofrojeni subvencione dhe ulje taksash pronarëve të pasurive që arrijnë vlerësimet më të larta në CPE ose që ndërmarrin rinovime të ndjeshme në efikasitetin energjetik, sidomos kur përputhen me objektivin e certifikimit të 150 NTZE-ve deri më 2031.*

HUA TË GJELBRA PËR NDËRTIM: *Bashkëpunim me institucionet financiare për të ofruar hua pa interes ose me interes të ulët për përmirësime në efikasitetin energjetik, duke u dhënë përparësi familjeve dhe sipërmarrjeve që investojnë në sisteme energjetike të rinovueshme krahas përmirësimeve në EPC.*

STIMUJ SIPAS REZULTATIT: *Ngrini skema sipas të cilave pronarët e banesave përfitojnë shpërblime financiare që mbështeten në kursime të matshme energjetike të diktuar pas përmirësimeve në pasuri.*

PARTINERITETE PUBLIK-PRIVAT: *Nxisni partneritete me sektorin privat për të financuar projekte rinovimi në shkallë të gjerë, duke përdorur kapitalin privat për të plotësuar fondet publike.*

Të tilla mjete financiare do të ulin barrën mbi pronarët e pasurive, duke nxitur përputhjen me standardet e performancës së energjisë dhe do të shtyjnë adoptimin e teknologjive me energji të përtëritshme në përputhje me ligjin "Për energjinë e rinovueshme".

3. FUQIZIMI I MEKANIZMAVE TË ZBATIMIT

Kosova ka nevojë për një sistem më të fuqishëm të përputhjes me CPE, duke përfshirë inspektime rutinore, monitorim në kohë reale dhe masa shtrënguese për mospërputhje. Adoptimi i platformave digjitale për gjurmimin



e lëshimit të CPE-ve dhe integrimin e këtyre platformave në sistemet e pasurive të paluajtshme dhe ato bashkiake do të rrisë transparencën dhe llogaridhënien.

4. RRYTJA E NDËRGJEGJËSIMIT DHE ANGAZHIMIT PUBLIK

Fushatat e ndërgjegjësimit publik që fokusohen te përfitimet nga CPE-të dhe rritja e efikasitës së energjisë janë themelore për të shtyrë para përafrimin dhe për të nxitur pronarët e pasurive që të investojnë në efikasitë në energji. Këto fushata lypset të përdorin kanale të shumfishta, që përfshijnë qeveritë vendore, median, ngjarjet në komunitet, me qëllim zgjerimin e rrezes së veprimt.

5. PËRMIRËSIMI I KAPACITETEVE KOMUNALE

Zyrat vendore të energjisë lypset të pajisen më mirë me financim, personel dhe ekspertizë teknike për të trajtuar detyra që lidhen me CPE-të, si certifikime, audite dhe inspektime. Decentralizimi i përgjegjësisë dhe fuqizimi i qeverive vendore mund të mbushë hendekun mes politikave kombëtare dhe zbatimit në nivel komuniteti.

6. ZGJERIMI I MEKANIZMAVE FINANCIARE

Për të nxitur përmirësime në ndërtesa Kosova duhet të paraqesë:

- Subvencione dhe stimuj taksimi për të arritur vlerësime më të larta në CPE dhe për të vënë në zbatim sisteme me energji të përtëritshme.*
- Hua me interes të ulët për projekte rinovimi dhe përmirësimi me efikasitë në energji.*
- Stimuj pas suksesit, për të matur kursimet në energji.*

Këto mekanizma do të pakësojnë barrën financiare mbi pronarët e pasurive, duke i bërë përmirësimet me efikasitë energjie më të aksesueshme.

7. PËRSHPEJTIMI I DIGJITALIZIMIT

Zhvillimi i platformës së centralizuar digjitale për CPE-të mundëson gjurmim, raportim dhe analizë të efektshme të performancës së energjisë. Kjo platformë duhet të përfshijë



elemente për lëshimin e CPE-ve, monitorimin e përputhjes dhe lehtësimin e aksesit publik në të dhëna për performancën energjitike.

8. VËNIA E STANDARDEVE PËR NDËRTESA ME THUAJSE ZERO ENERGJI

Kosova duhet të përshpejtojë hartimin e standardeve të NTZE, duke i bërë të detyrueshme për ndërtesat e reja dhe rinovimet domethënëse. Direktiva të qarta për përputhjen me kriteret për NTZE do të mbështesin kalimin e Kosovës drejt përdorimit të qëndrueshëm të energjisë.

9. INTEGRIMI I ENERGJISË SË PËRTËRITSHME ME KORNIZAT CPE

- Korniza CPE lypset të integrojnë më mirë adoptimin e energjisë së përtëritshme duke:*
- Mandatuar audite energjie për të vlerësuar potencialin e ndërtesës për energji të rinovueshme.*
- Ofruar stimuj të posaçëm për instalime diellore, biomase dhe burimeve të tjera të përtëritshme të energjisë.*
- Caktuar objektiva për energji të rinovueshme për ndërtesat krahas klasifikimit të CPE.*

10. ZGJERIMI I PROGRAMEVE PËR TRAJNIM DHE NGRITJE KAPACITETESH

Kosova duhet të rrisë mundësitë e trajnimit për audituesit, certifikuesit e energjisë, dhe për zyrtarët vendorë me qëllim zbatimin vijueshmërisht të standardeve të CPE. Partneritetet me organizmat ndërkombëtare si BE mund të ofrojnë ndihmesë dhe burime teknike për të mbështetur këto programe.

11. PËRKRAHJA E PËRFSHIRJES SË SEKTORIT PRIVAT

Incourajimi i pjesëmarrjes së sektorit privat përmes partneriteteve publik-privat do të tërheqë investim në projekte rinovimi në shkallë të gjerë. Këto partneritete mund të përdorin

financim privat për të plotësuar programe publike dhe të zgjerojnë sferën e shtrirjes së nismave me efikasitet energjetik.

Duke u fokusuar në këto fusha kyçe politike Kosova mund të përmirësojë kornizën e vet CPE, të përafrohet me direktivat e BE-së dhe të arrijë objektivat e veta për efikasitet energjetik dhe klimën më me efektshmëri. Këto përmirësime do të fuqizojnë dhe pozicionin e Kosovës si prijës rajonal në praktikën e qëndrueshme të energjisë.

SHQIPËRIA

Për të fuqizuar kornizën e Shqipërisë për Certifikatën e Performancës Energjetike dhe për të arritur përputhshmëri më të madhe me standardet e BE-së, rekomandohen përmirësimet vijuese në politika:

1. RRITJA E MEKANIZMAVE TË ZBATIMIT DHE MONITORIMIT

Shqipëria duhet të vërë në zbatim një sistem të mirë inspektimi për të monitoruar përputhjen e CPE dhe për të zbatuar sanksionet për mospërputhshmëri. Një qasje e digjitalizuar për gjurmimin e përputhshmërisë mund të garantojë vijimësi dhe transparencë nëpër rajone.

2. PËRKRAHJA E NDËRGJEGJËSIMIT PUBLIK

Fushata të gjera ndërgjegjësimi publik për edukimin e pronarëve të pasurive për përfitimet nga CPE dhe nga përmirësimet në efikasitetin energjetik. Partneriteti me bashkitë, mediat dhe organizatat vendore mund të zgjerojë shtrirjen e këtyre nismave.

3. ZHVILLIMI I PLATFORMAVE DIGJITALE

Investoni në platforma digjitale të centralizuara për të administruar lëshimin e CPE, për të gjurmuar performancën e energjisë dhe për t'i integruar me tregun e pasurive të patundshme. Kjo do të lehtësojë monitorimin e përputhshmërisë dhe do të përmirësojë mbledhjen e të dhënave për analiza politike.

4. ZGJERIMI I STIMUJVE FINANCIARË

Fusni në veprim mekanizma financiare gjithëpërfshirëse si:

- *Subvencione dhe stimuj taksimi për arritjen e klasifikimit të lartë në CPE ose vënien në zbatim të sistemeve me energji të rinovueshme.*
- *Hua me interesa të ulëta për renovime me efikasitet energjie dhe projekte rinovimi.*
- *Shpërblime sipas suksesit të arrirë që lidhen me kursime energjie të matshme.*

5. PËRSHPEJTIMI I INTEGRIMIT TË ENERGJIVE TË RINOVUESHME

Forconi lidhjen mes kornizës së CPE dhe adoptimit të energjisë së përtëritshme duke:

- *Ofruar stimuj të përshtatur për instalimin e sistemeve me energji të përtëritshme.*
- *Mandatuar audite energjie për të vlerësuar potencialin e ndërtesave për energji të përtëritshme.*

6. NISMA PËR NGRITJE KAPACITETESH

Zgjeroni programet e trajnimit për auditues, certifikues energjie dhe për zyrtarë vendorë. Bashkëpunoni me institucionet e BE-së për të ofruar ndihmesë teknike dhe burime për ngritje kapacitetesh.

7. VËNIA DHE ZBATIMI I STANDARDEVE TË NTZE

Përshejtoni hartimin e standardeve për ndërtesa me thuajse zero Energji (NTZE), duke i bërë të detyrueshme për ndërtesat e reja dhe ato me renovime madhore, sipas kritereve të BE-së.

8. FUQIZONI ROLET KOMUNALE

Pajisni zyrtarët bashkiakë me burime të mjaftueshme, ekspertizë teknike dhe autoritet për të administruar zbatimin e CPE-ve dhe përputhjen në nivel vendor.



Duke u marrë me këto hendeqe dhe duke vënë në jetë përmirësimet e rekomanduara, Shqipëria mund të forcojë kornizën e vet për CPE dhe të kontribuojë më efektshëm në objektivat klimatike dhe për efikasitet energjie, si dhe duke u përfruar me direktivat e BE-së.



RRETH PROJEKTIT

Megenëse ndërtesat përbëjnë pjesën më të madhe të konsumit të energjisë në Evropë, përmirësimi i efikasitetit energjitik dhe pakësimi i konsumit të energjisë në to janë shtylla kryesore në arritjen e një stoku ndërtesash të çkarbonizuara deri në vitin 2050, duke kontribuar në vënien në jetë të Marrëveshjes së Gjelbër Europiane.

Kosova dhe Shqipëria, të dyja potencialisht vende kandidatë për anëtarësim në BE, kanë disa nga stoqet e ndërtimit më joefikente dhe dy nivelet më të larta të varfërisë energjetike (përkatësisht 40% dhe 37%) në Europë. Pavarësisht planeve për të pakësuar konsumin e energjisë, Kosova dhe Shqipëria nuk kanë kornizë politike të përshtatshme për përmirësim – veçanërisht në sektorin e ndërtesave të banimit – dhe masa mbështetëse që do të përshpejtonin rinovimet.

Duke u mbështetur në analiza të bazuara në prova, projekti u orfron qeverive të Kosovës dhe Shqipërisë rekomandime politike për përmirësimin e efikasitetit të energjisë në ndërtesa. Partnerët kosovarë dhe shqiptarë japin ekspertizë sipas dy konteksteve kombëtare dhe përfshihen me grupet e synuara në çdo vend, ndërsa partnerët polakë dhe hungarezë ndajnë ekspertizën e tyre në politikat e BE-së. Trajnimet, punëtoritë dhe konsultimet janë organizuar për tu dhënë administratave qendrore dhe vendore njohuritë dhe mjetet e nevojshme për të përpiluar strategji rinovimi afatgjatë, në përputhje me politikat e BE-së, duke përfshirë dhe Kuadrin për Certifikatën e Performancës në Energji.

Vëmendje e projektit është dhe varfëria energjitike, veçanërisht e dukshme në Kosovë dhe Shqipëri. Rekomandimet politike janë hartuar, autoriteteve vendore dhe qeverisë qendrore u janë dhënë direktiva se si të përhapin informacionin te qytetarët dhe sektori privat për masat e efikasitetit të energjisë në rinovime. Qeveritë vendore, sektori privat dhe shoqëria civile janë trajnuar për të ngritur ZIN si



mjete për të lehtësuar dhe përshpejtuar rinovime ndërtesash që janë miqësore me klimën.

Mbështetja për vënien në jetë në Kosovë dhe Shqipëri të legjislacionit të BE-së për klimën dhe energjinë mund të ndihmojë dhe në rrugëtimin e tyre drejt anëtarësimit në BE.

